



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr. 557-6392 /2019

Klinë, dt.13.02.2019

Duke u bazuar ne dispozitat nenit 13 dhe 58 te Ligjit per Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040 publikuar ne Gazetën Zyrtare 28/2010, dispozitat e nenit 6 te Ligjit per Eficiencë te Energjisë, nr.06/L-079, si dhe dispozitat e nenit 91 te Statutit te Komunës së Klinës, me qellim te përmbushjes se obligimeve ligjore, kryetari i Komunës së Klinës me datën 13.02.2019 lëshon, këtë:

## V E N D I M

Per formimin e grupit punues per hartimin e planit për eficiencë te energjisë

1. **FORMOHET**, grupi punues per hartimin e Planit te Veprimit per Eficiencë të energjisë per Komunën e Klinës, ne këtë përbërje, si ne vijim:
  - 1.1. Iber Elezaj, udhëheqës i grupit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente;
  - 1.2. Halil Bekaj, Drejtoria e Administratës;
  - 1.3. Suzana Gjergji, Drejtoria e Arsimit;
  - 1.4. Rexhë Buqani, Drejtoria e Kulturës;
  - 1.5. Driton Berisha, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
  - 1.6. Ahmet Berisha, Drejtoria e Administratës;
  - 1.7. Shaqir Elezaj, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.
2. Grupi punues ka per obligim te përgatis dhe dorëzoj në AKEE draft-planin komunal të veprimit për eficiencë të energjisë, i cili do të përfshijë politikat e propozuara të eficiencës së energjisë dhe masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë, të cilat mbulojnë të gjithë sektorët që funksionojnë në nivel komunal. Para miratimit të Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë nga Kuvendi i Komunës, Agjencia e Kosovës per Eficiencë te Energjisë (AKEE) do të vlerësojë përputhshmërinë e tij me politikat kombëtare të eficiencës së energjisë, caqet dhe planet përkatëse dhe ta japë opinionin me rekomandime, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e parashtrimit të draft-planit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Grupi punues ka per obligim te kryej te gjitha procedurat ne përputhje me dispozitat e Ligjit per Eficiencë te Energjisë, nr.06/L-079, si dhe aktet tjera ligjore e nënligjore.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë ne fuqi menjëherë, mbikëqyrjen e zbatimit te te cilit e bene kryetari i komunës.

### Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- GIZ-i;
- Arkivi.

Kryetari,  
Zenun Elezaj

